UDHËZIM
Nr. 597, datë 22.12.2017

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE, ASISTENCË SHTËPIAKE, PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 27 dhe 51, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe/ose strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror apo, dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit, në qarkun përkatës.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

STANDARDET

E ASISTENCËS SHTËPIAKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

HYRJE

Hartimi i dokumentit të standardeve të shërbimit asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara (në vijim PAK) përbën një hap të rëndësishëm për rritjen e kujdesit social për këtë kategori në nevojë. Standardet plotësojnë detyrimet në zbatim të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe të ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Standardet e reja të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara do të shërbejnë si një instrument bazë për sigurimin dhe matjen e cilësisë së shërbimeve dhe garantimin e ushtrimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, ligjin për antidiskriminim, ligjin nr. 9355, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me "Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe "Konventën të Rehabilitimit Komunitar", të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Standardet e shërbimit të asistencës shtëpiake për PAK-në bazohen mbi parimet e njohura të kujdesit social, si:

Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit;

Drejtësisë sociale;

Partneriteti;

Subsidiariteti,

Decentralizimi, ku shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve;

Mosdiskriminimi;

Integrimi shoqëror;

Gjithëpërfshirja;

Liria;

Siguria;

Pavarësia.

Hartimi i standardeve të asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara është një ndër objektivat e reformimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ky reformim synon deinstitucionalizimin e shërbimeve, pasurimin e llojshmërisë së shërbimeve për PAK-në dhe rritjen e cilësisë së tyre, për t'iu përgjigjur nevojave të personave me aftësi të kufizuara për përkujdesje, në ambientin e tyre natyral në kohë dhe me cilësi.

Këto standarde do të rrisin numrin e personave që do të marrin shërbime dhe do të përmirësojnë pjesëmarrjen në jetën e komunitetit dhe gjithëpërfshirjen.

Ky shërbim i ri social i asistencës shtëpiake siguron, për aq sa është e mundur, ofrimin e shërbimit pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore.

Shërbimi në shtëpi siguron integrimin e shërbimeve të kujdesit ditor që u ofrohet në familje personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët. Ky shërbim përfshin:

I. Përmbushjen e nevojave të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti;

II. Furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;

III. Furnizimin e barnave apo furnizime të tjera jetike;

IV. Shërbime bazë mjekësore dhe infermie-ristike;

V. Mbajtjen e higjienës personale;

VI. Shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillimi psikologjik e ligjor sipas rastit.

Dokumenti i standardeve të shërbimit asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara do të ndihmojë në radhë të parë vetë përfituesit e shërbimeve dhe familjarët e tyre për të kuptuar dhe për kërkuar zbatimin e standardeve nga ofruesit e shërbimeve.

Standardet do të shërbejnë si udhëzues praktik dhe konkret për ofruesit e shërbimeve, për të organizuar dhe për të përmirësuar shërbimet sipas kërkesave të dokumentit.

Standardet sanksionojnë që ofrimi i këtij shërbimi do të realizohet vetëm nga figura profesionale të certifikuara, si punonjës socialë, psikologë, infermierë etj.

Nga pikëpamja praktike, organizative dhe menaxheriale, standardet e përgjithshme të shërbimeve dhe standardet specifike të shërbimit të asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara do të jenë të unifikuara për të gjitha strukturat e shërbimeve shoqërore shëndetësore të njësive të qeverisjes

vendore. Ky shërbim i asistencës shtëpiake do të ofrohet prej tyre ose do të "blihet" si shërbim jopublik nga OJF-të ose njësitë e specializuara private për të ofruar këtë shërbim.

Paketa e re e standardeve vendos rregulla dhe kritere për cilësinë e shërbimeve, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë ofruesit e shërbimeve, si nga institucionet publike, nga shërbimet e ngritura nga organizatat jofitimprurëse (OJF) dhe nga ofrues të tjerë privatë.

Dokumenti i standardeve të shërbimit të asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara do të shërbejë, për:

- Ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shërbimet e kujdesit shoqëror, në nivel qendror e vendor, për vlerësimin e kapaciteteve të ofruesve dhe pajisjen e tyre me licencë;
- Inspektoratin përgjegjës për shërbimet shoqërore, për të vlerësuar shërbimet dhe për të matur arritjen e kërkesave të caktuara të standardeve, që ofrohen në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara;
- Njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit/strukturën e posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shëndetësor në nivel vendor, për të përmbushur funksionet e reja që lidhen me plotësimin e nevojave sociale të komunitetit, identifikimin dhe vlerësimin e tyre, planifikimin dhe alokimin e fondeve përkatëse për ngritjen dhe mbështetjen e shërbimit të ri: "Asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara";
- Institucionet publike të përkujdesjes, OJF-të dhe ofruesit privatë si instrumente në procesin e realizimit të shërbimit të asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara;
- Institucionet akademike dhe organizatat e përfshira në veprimtari arsimore e trajnuese, studiues të fushës shoqërore.

Në procesin e hartimit të standardeve është mbajtur parasysh arritja e një niveli të caktuar shërbimesh, që garantojnë mjedis të sigurt për personat me aftësi të kufizuara, përkujdesje cilësore dhe jetesë sa më aktive për ta.

Standardet mbulojnë të gjitha fushat e veprimtarisë jetësore të personave me aftësi të kufizuara, përfitues të shërbimeve në familje, si:

1. Informacioni dhe vizita paraprake. Sipas këtij standardi personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët vendosin mbi shërbimet që do të marrin, pasi kanë marrë informacionin e duhur dhe janë siguruar se ky shërbim do të plotësojë nevojat dhe kërkesat e tyre.
2. Vlerësimi paraprak i nevojave të klientëve dhe hartimi i një plani individual përkujdesjeje. Ky standard siguron që personave me aftësi të kufizuara që banojnë në banesë, t'u ofrohen shërbimet e duhura që plotësojnë nevojat dhe kërkesat e tyre.
3. Kujdesi shëndetësor dhe mjekimi sipas planit individual të përfituesit. Sigurohet që ofruesi i shërbimeve nxit dhe ruan shëndetin e klientëve mbi bazën e një plani individual, që merr në konsideratë kryerjen e vizitave dhe analizave të nevojshme, ndjekjen e këshillave të mjekut dhe të trajtimit me barna.
4. Respektimi i intimitetit dhe i dinjitetit. Personave me aftësi të kufizuara t'u sigurohet intimiteti dhe dinjiteti i nevojshëm për higjienën personale, duke iu ofruar ndihmë me ngrohtësi, durim dhe respekt.
5. Jeta sociale në shtëpi dhe lidhjet me komunitetin. Ritmi i jetesës dhe i aktiviteteve të përditshme ndryshon dhe u përshtatet dëshirave, kërkesave dhe kapaciteteve të përfituesve. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të presin vizitorë dhe të marrin pjesë në aktivitete familjare dhe të komunitetit.
6. Aktivitete integruese dhe plotësuese të kujdesit në shtëpi. Personave me aftësi të kufizuara u sigurohet shërbimi i ushqimit nëse është e nevojshme, si dhe/ose ndihmesa në përgatitjen e ushqimeve dhe lëngje të shëndetshme, të sigurta, të shumëllojshme e në sasi të mjaftueshme për gjendjen e tyre shëndetësore, si dhe që plotësojnë dëshirat e tyre.
7. Mbrojta e të drejtave të klientëve, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimimit. Klientët gëzojnë të gjitha të drejtat ligjore, mbrohen nga llojet e ndryshme të abuzimeve. Ankesat e tyre shqyrtohen seriozisht dhe shoqërohen me veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes.
8. Personel i kualifikuar për kryerjen e shërbimeve. Klientët marrin të gjitha shërbimet e nevojshme nga personeli i kualifikuar, si dhe përcaktimi i standardeve të tyre. Shërbimi i kujdesit shoqëror dhe shëndetësor në shtëpi duhet të ketë standarde dhe procedura homogjene në gjithë territorin kombëtar.
9. Shërbimet e asistencës shtëpiake sociale dhe shëndetësore në ambientin natyral familjar ofrohen nga figura profesionale dhe njësia vlerësimit dhe e referimit të rastit në bashki/struktura të posaçme apo një subjekt i licencuar. Duke përcaktuar kërkesat organizative dhe funksionale të subjektit. Personat me aftësi të kufizuara marrin shërbime profesionale me cilësi të mirë dhe që ndjekin procedura të rregullta referimi, vlerësimi, planifikimi dhe të dhënies së shërbimeve. Procedurat respektojnë parimin e

vendimmarrjes të mbështetur te përfituesit apo te përfaqësuesit të tij ligjor.

10. Njësia e qeverisjes vendore siguron partneritet me të gjitha grupet e interesit për personat me aftësi të kufizuara mbi bazën e parimeve të gjithëpërfshirjes. Njësitë administrative punojnë së bashku me personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, për parandalimin e shmangien e përjashtimit shoqëror.

Standardet janë konceptuar si standarde minimale të cilësisë. Në këtë kuptim ato do të përdoren si mjet gradual për të përmirësuar infrastrukturën e shërbimeve dhe për të reflektuar cilësinë e kërkuar të tyre.

Paketa e standardeve është sistemuar në dy seksione:

1. Seksioni i parë, ku përcaktohet standardi i cili shoqërohet me rezultatin e pritshëm.

2. Seksioni i dytë, ku janë vendosur kriteret për vlerësimin e standardit, si dhe treguesit për matjen e cilësisë së zbatimit të tij. Treguesit do të shërbejnë edhe si bazë për inspektimin e shërbimit të asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara nga inspektorati i shërbimeve, strukturat vendore, vetë të moshuarit dhe të afërmit e tyre.

STANDARDI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILËSISË
Standardi 1 *Informimi i përdoruesve të shërbimeve* **Punonjësit socialë përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar në njësinë e qeverisjes vendore pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit/dhe ose strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, duhet të kenë përcaktuar një manual, të shoqëruar me protokollet përkatëse për çdo shërbim për personat me aftësi të kufizuara (në vijim "PAK") dhe/ose përfaqësuesit të tyre ligjor, ku përshkruan me saktësi misionin, qëllimin, objektivat e shërbimit, si dhe modelin e shërbimit që ofrohet.**	Personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe/ose përfaqësuesit e tyre ligjorë udhëzohen dhe kanë njohuri se si do të bëhet përkujdesja ndaj tyre. Një manual, i plotësuar me protokollet respektive për çdo shërbim, ku shpjegohet qartë karta e shërbimeve së bashku me procedurat përkatëse se si operon subjekti është e disponueshme për personat me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe të interesuarit e tjerë.	1. Një përkufizim i qartë i misionit dhe i qëllimit, i objektivave të shërbimit të përkujdesjes në shtëpi, ku parashtrohen shërbimet që ajo ofron, është lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë përdoruesit dhe të interesuarit e këtij shërbimi.	1.1. Manual i hartuar lidhur me qëllimin e shërbimit. 1.2. Protokollet e ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
	Punonjësit socialë në njësinë e vlerësimit të nevojave pranë sektorit të posaçëm të shërbimeve në nivele vendore, që ndjekin çështjet e aftësisë së kufizuar, dhe/ose nëpërmjet shërbimeve të kontraktuara ofrojnë një paketë shërbimesh, duke respektuar protokollet, në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara në bashkëpunim edhe me ofruesit të shërbimeve shëndetësore, për të mundësuar një kujdes dhe mirëqenie për çdo person me aftësi të kufizuara, në interesin e tij më të lartë.	2. Familjarët, përfituesit e shërbimeve, si dhe të interesuarit e tjerë, kanë akses te manuali/ protokollet, ku shpjegohet deklarata e qëllimit, misioni, llojet e asistencës shtëpiake, së bashku me procedurat përkatëse, se si operon subjekti.	2.1. Kopje të manualit janë të disponueshme për përdoruesit, si dhe në forma lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë. 2.2. Kopje të protokolleve janë të disponueshme për përdoruesit, si dhe në forma lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë.

		3. Punonjësi social dhe/ose subjekti i kontraktuar ofron informacion lidhur me funksionimin e shërbimit në shtëpi që do t'u ofrohet personave me aftësi të kufizuara, cilat janë shërbimet minimale, shtesë apo të specializuara që ofrohen në shtëpi apo mundësohen prej saj.	3. Personat me aftësi të kufizuara, familjarët ose përfaqësuesit e tyre ligjorë, konfirmojnë se kanë marrë informacion nga punonjësi social mbi qëllimin dhe procedurat e shërbimit dhe e kuptojnë atë pasi ajo është diskutuar me ta. Personat me aftësi të kufizuara dhe/ose përfaqësuesit e tyre ligjorë kanë një kopje të manualit dhe të protokolleve. Konfirmimi duhet të jetë i dokumentuar.
		4. Manuali dhe protokollet rishikohen, përmirësohen dhe përditësohen rregullisht.	4. Dokumentet dhe aktet zyrtare tregojnë që këto manuale janë diskutuar dhe rishikuar rregullisht.
Standardi 2 *Vlerësimi dhe plotësimi i nevojave dhe i qëllimeve individuale* **Përpara apo gjatë marrjes së shërbimeve, personat me aftësi të kufizuara vlerësohen nga njësia e vlerësimit të nevojave/sektori i posaçëm i njësisë administrative. Ky vlerësim përshkruan të gjitha aftësitë e personit dhe pasqyron, sipas rastit, nevojat e tij individuale aftësuese dhe riaftësuese fizike, shëndetësore, psikologjike, njohëse, komunikative, shoqërore, për të jetuar në komunitet dhe për të realizuar funksionet e moshës përkatëse në mënyrë sa më të pavarur.**	Çdo person me aftësi të kufizuara, pas procesit të vlerësimit të nevojave, merr shërbime që plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tij për një jetesë sa më të pavarur duke parandaluar institucionalizimin.	1. Një ekip me specialistë është përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, për secilin nga komponentët e shërbimit: shëndeti, ushqimi marrëdhëniet familjare dhe me komunitetin, aktivitetet sociale.	1.1. Është ngritur një ekip multidisiplinar, që njeh përgjegjësitë e tij lidhur me vlerësimin dhe planifikimin në fushën e kujdesit. 1.2. Çdo pjesëtar i ekipit ka të qartë detyrën e tij dhe ka përgatitur e përditësuar rubrikën që ka nën përgjegjësi.
		2. Ka një procedurë të qartë vlerësimi, që përfshin së paku fushat e vlerësimit, metodikën e vlerësimit dhe rolin e përfituesit të shërbimeve në këtë proces. Fushat e vlerësimit janë: - Situata familjare dhe e kontekstit social, ambiental dhe të marrëdhënieve; - Karakteristikat funksionale, organike dhe të sjelljes së personit; - Gjendja ekonomike.	2.1. Dokumenti i njësisë së vlerësimit të nevojave që përshkruan procedurën e vlerësimit mbi personin me aftësi të kufizuara. 2.2. Shembuj të vlerësimeve të përfunduara të firmosura si nga personeli ashtu edhe nga përfituesi/përfaqësuesi ligjor. Përfituesi zotëron kopje të vlerësimit të tij. 2.3. Formulari tip për procesin e vlerësimit. 2.4. Përfituesit e shërbimeve/përfaqësuesit e

		Vlerësimet e mësipërme së bashku me dokumentacionin përkatës do të mblidhen në një dosje personale e cila do të raportojë performancën dhe procedurat e dhënies së kujdesit në shtëpi.	tyre ligjor konfirmojnë përfshirjen e tyre në procesin vlerësues. 2.5. Punonjësi social konfirmon përfshirjen e tij dhe të përfituesve të shërbimeve në procesin e vlerësimit.
		3. Njësia e vlerësimit të nevojave përfaqëson nevojat dhe kërkesat specifike të përfituesit. Ajo mund të kërkojë ekspertizë të specializuar me specialistë të fushës që ofrojnë shërbime të ngjashme edhe nga ndonjë subjekt i licencuar.	3.1. Dokumentacioni tregon që profesionistët që bëjnë vlerësimin u përkasin fushave ku janë identifikuar paraprakisht nevojat dhe kërkesat e personit. 3.2. Formulari i vlerësimit.
		4. Personat me aftësi të kufizuara/përfaqësuesit e tyre ligjor janë pjesëmarrës aktivë në procesin e vlerësimit; mendimi i tyre kërkohet, vlerësohet dhe merret në konsideratë.	4.1. Dokumenti që përshkruan procedurën e vlerësimit nga njësia e vlerësimit të nevojave përshkruan pjesëmarrjen e personit me aftësi të kufizuara/përfaqësuesit të tij ligjor në këtë proces. 4.2. Dokumenti i vlerësimit firmoset nga përfituesi/përfaqësuesi i tij ligjor. 4.3. Përfituesi i shërbimeve apo përfaqësuesi i tij ligjor marrin një kopje të dokumentit të vlerësimit. 4.4. Intervista me përfituesit e shërbimeve/ përfaqësuesit të tyre ligjor tregon se mendimi i tyre është kërkuar, vlerësuar dhe marrë në konsideratë.
		5. Procesi i vlerësimit vë në qendër personin me aftësi të kufizuara dhe ndërtohet duke pasur parasysh moshën, aftësitë, nevojat dhe pikësynimet e tij. Sa herë që është e mundur, kryhet në mjedisin e zakonshëm ku jeton.	5.1. Dokumenti i vlerësimit tregon se vlerësimi ka pasur parasysh moshën e personit dhe problematikën shëndetësore të evidentuar. 5.2. Procedura e vlerësimit përcakton marrjen e mendimit të personit të vlerësuar apo përfaqësuesit të tij ligjor mbi pikësynimet

			e punës. 5.3. Intervista me personat me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesit e tyre ligjorë tregon se vlerësimi ka pasur parasysh veçoritë e moshës dhe është kryer kur ka qenë e mundur në mjedisin e zakonshëm ku jeton. 5.4. Vizitat në shtëpi të personit me aftësi të kufizuara të dokumentuara janë pjesë e procesit të vlerësimit
		6. Vlerësimi evidenton mundësitë dhe aftësitë e individit, si dhe fushat e nevojës për mbështetje me qëllim që të mbështetet në mjedisin e tij familjar dhe të parandalohet institucionalizimi.	6.1. Dokumenti i vlerësimit evidenton mundësitë dhe aftësitë e personit për të kryer veprimet e jetës së përditshme, si edhe funksione të tjera të lidhura me moshën e tij. 6.2. Vlerësimi i fushave të nevojës për mbështetje përfshin rritjen e pavarësisë së tij në ambientin e tij natyral familjar.
		7. Vlerësimi i plotë bëhet së paku një herë në 1 (një) vit. Vlerësimi i ecurisë bëhet së paku një herë në 3 muaj.	7.1. Vlerësimi i plotë është bërë jo më pak se një vit. 7.2. Dokumenti i vlerësimit të ecurisë është bërë jo më parë se 3 muaj përpara. 7.3. Vlerësimi plotë mjekësor është bërë jo më pak se një vit përpara.
Standardi 3 *Plani i përkujdesjes për personat me aftësi të kufizuara* **Në bazë të vlerësimit dhe dëshirave e pikësynimeve të personave me aftësi të kufizuara ndërtohet plani individual, i cili kur është i nevojshëm, përmban masat për parandalimin dhe trajtimin e çrregullimeve**	Planet me shkrim paraqesin mënyrat se si do të plotësohen nevojat dhe si do të zbatohen këto plane. Njëkohësisht ato paraqesin edhe progresin e arritur në zbatimin e planit. Çdo person me aftësi të kufizuara konsiderohet si një individ dhe për të ka një plan individual.	1. Mbi bazën e vlerësimit, brenda 5 ditëve pune nga marrja e kërkesës duhet të fillojnë procedurat për përcaktimin e planit individual të kujdesit (PIK), që përmban domosdoshmërisht tregues të matshëm të realizimit të objektivave afatgjatë, afatmesëm e afatshkurtër të vendosur për punën me përfituesin Në rast urgjence, procedurat e marrjes në ngarkim dhe të përpunimit të planit individual të kujdesit	1.1. Treguesit e realizimit të objektivave afatshkurtër ose afatmesëm në planin individual sipas afateve kohore të përcaktuara në plan. 1.2. Treguesit e realizimit të objektivave janë të matshëm. 1.3. Personi me aftësi të kufizuara apo personi përgjegjës për të merr një raport

të sjelljes, si dhe për parandalimin e institucionalizimit. Ecuria e zbatimit të planit individual vlerësohet rregullisht.		reduktohen në 3 ditë pune.	ecurie të përpiluar nga punonjësi social që kryen shërbimet, së paku dy herë në vit për treguesit e realizimit të objektivave.
		2. Plani individual përmban mbështetjen që do t'i jepet personit për të siguruar realizimin e objektivave. Objektivat janë të lidhur me mbështetjen e përfituesit në ambientin e tij natyral dhe familjar, duke u siguruar që besimi shoqëror, kulturor dhe fetar njihet dhe respektohet.	2.1. Plani individual përfshin punën që do të kryhet nga të gjithë specialistët, si nga punonjësi social i njësisë vlerësimit të nevojave/struktura posaçme e njësisë administrative, po kështu dhe nga mjeku i familjes në bashkëpunim me strukturat shëndetësore. 2.2. Plani individual parashikon takime kolektive për programimin dhe vlerësimin e aktiviteteve midis operatorëve dhe punonjësit socialë që ka edhe funksionet e koordinatorit të shërbimit. 2.3. Në plan është përfshirë bashkëpunimi i të afërmve, miqve dhe personave të tjerë të rëndësishëm në jetën e personit përfitues. 2.4. Plani individual përfshin pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe kontakte të rregullta me bashkëmoshatarët në mjedise komunitare. 2.5. Plani individual përfshin përshtatjet e arsyeshme dhe/ose përdorimin e teknologjisë ndihmëse ose gjuhës së shenjave që mundësojnë gjithëpërfshirjen e personit me aftësi të kufizuara në jetën e komunitetit dhe rrisin pavarësinë e tij funksionale.

		3. Plani për trajtimin e çrregullimeve të sjelljes përmban trajtime dhe kufizime që nuk cenojnë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin dhe lirinë e personit me aftësi të kufizuara.	3.1. Plani përcakton marrjen e masave të mundshme për të parandaluar manifestimet e çrregullimeve të sjelljes. 3.2. Masat e planifikuara për parandalimin e çrregullimeve të sjelljes dhe trajtimin e tyre përmbajnë mbështetje të sjelljeve pozitive dhe shpërblime për to. 3.3. Masat që janë planifikuar për të trajtuar çrregullimet e sjelljes nuk cenojnë dinjitetin e personit dhe nuk përbëjnë dhunë apo keqtrajtim fizik dhe/ose psikologjik. 3.4. Plani përcakton që trajtimi i rasteve të çrregullimeve të rënda të sjelljes dhe veçimi nuk përdoren si dënim, por si një masë për të parandaluar rrezikun ndaj vetes dhe të tjerëve. 3.5. Masat që merren për të trajtuar rastet e çrregullimeve të rënda të sjelljes nuk përmbajnë asnjë rrezik për jetën dhe shëndetin e personit. 3.6. Plani parashikon monitorimin e pandërprerë të personit gjatë periudhës së veçimit të tij. 3.7. Të gjithë personat që trajtojnë çrregullimet e rënda të sjelljes kanë marrë trajnimin e duhur profesional për metodikën e përdorur. 3.8. Të gjithë punonjësit e subjekteve të licencuara marrin trajnim për trajtimin e çrregullimeve të rënda të sjelljes. Ekziston dokumenti që vërteton trajnimin. 3.9. Plani parashikon njoftimin e familjes për incidentin e çrregullimit të sjelljes dhe masat e marra për ndërprerjen e tij. 3.10. Dosja e personit me aftësi të kufizuara përmban përshkrimin e çdo incidenti të

			çrregullimeve të rënda të sjelljes dhe masat e marra për ndërprerjen e tyre. Dokumenti është nënshkruar nga drejtuesi i subjektit të licencuar apo personi përgjegjës për ndjekjen e çrregullimeve të rënda të sjelljes.
		4. Sa herë që është e nevojshme, gjatë procesit të vlerësimit dhe hartimit të planit individual, identifikohen nevojat për trajtimin e çrregullimeve të sjelljes dhe krijohet një plan për masat që duhen marrë gjatë episodeve të çrregullimeve të sjelljes, si edhe punën që duhet bërë për parandalimin dhe uljen e frekuencës së tyre.	4.1. Dokumenti i vlerësimit ka një pjesë të veçantë për vlerësimin e çrregullimeve të sjelljes. 4.2. Plani për masat që duhen marrë gjatë çrregullimeve të sjelljes për të mos lejuar dëmtimin e personit dhe e të tjerëve. 4.3 Plani përmban si minimum identifikimin e faktorëve që shkaktojnë çrregullimin e sjelljes, dhe metoda të mbështetjes së sjelljes pozitive për parandalimin dhe uljen e frekuencës.
		6. Është caktuar një person përgjegjës për zbatimin e planit dhe raportimin e progresit për çdo PAK.	6. Për çdo PAK ka një person përgjegjës që kujdeset në bashkëpunim me të/personin kujdestar për zbatimin e planit.
		7. Plani individual rishqyrtohet së paku një herë në vit.	7.1. Çdo person ka në dosje një plan individual që është hartuar jo më parë se një vit. 7.2. Individi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka marrë një kopje personale të planit individual.
Standardi 3 ***Kujdesi shëndetësor dhe mirëqenia personale sipas planit individual të përfituesit***	Në bashkëpunim të ngushtë me përfituesit e shërbimit/përfaqësuesin ligjor, personit me aftësi të kufizuara i plotësohen të gjitha nevojat në bazë të një plani individual shëndetësor.	1. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet në bashkëpunim me përfituesin e shërbimit/ përfaqësuesin ligjor dhe ndryshohet sipas nevojës, jo më rrallë se një herë në gjashtë muaj.	1.1. Përfituesi ka një kopje të planit të tij shëndetësor. 1.2. Një kopje e planit të kujdesit shëndetësor është në dosjet personale të përfituesit.

Sipas nevojës dhe kërkesës së tij hartohet plani shëndetësor individual, i cili parashikon që personat me aftësi të kufizuara të marrin barnat, të ruajnë higjienën vetjake, dhe mirëqenien psikologjike.		2. Plani i kujdesit shëndetësor ka procedura të qarta për mbajtjen dhe dhënien e barnave që mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga abuzimi me barnat dhe keqpërdorimi i tyre.	2.1. Procedurat përcaktojnë se barnat jepen, vetëm me rekomandimin e mjekut të familjes/mjekut të specializuar. 2.2. Procedurat përcaktojnë që barnat mbahen të mbyllura me çelës, që zotërohet vetëm nga personeli i caktuar për shpërndarjen e tyre. 2.3. Personeli i caktuar për shpërndarjen e barnave, ka marrë një trajnim mbi procedurat e mbajtjes së barnave dhe shpërndarjes së tyre, si edhe për masat që duhen marrë në raste problematike. Hartohet dokumenti që vërteton trajnimin. 2.4. Personeli i caktuar për shpërndarjen e barnave, mban shënime të rregullta për shpërndarjen e barnave, që si minimum përmbajnë: emrin, orën, barnat, dozën, mënyrën e marrjes dhe emrin e personit që bën shpërndarjen dhe reaksionet e vëna re.
		3. Plani i kujdesit shëndetësor ka procedura të qarta, që përcaktojnë trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjekësore.	3.1. Procedurat përshkruajnë rastet që do të përcaktohen si incidente, aksidente dhe emergjenca mjekësore. 3.2. Procedurat përshkruajnë masat që do të merren në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave mjekësore. 3.3. Procedurat përshkruajnë njoftimin e familjeve të personave në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave. 3.4. Ka një dosje ku mbahen raportet e rasteve të incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjekësore.
		4. Plani i kujdesit shëndetësor ka procedura të qarta që përcaktojnë dhënien e shërbimit shëndetësor dhe terapeutik përfituesit, si dhe	4.1. Procedurat përshkruajnë masat që do të merren kur përfituesi përjeton kujdes shëndetësor dhe terapeutik që mbështet masat e tyre fizike, sjelljes dhe mirëqenies

		kohëzgjatjen e tij.	psikologjike. 4.2. Procedurat përshkruajnë kohëzgjatjen e dhënies së kujdesit që u përshtatet nevojave specifike të rastit dhe ndahen në varësi të intensitetit të ndërhyrjes, në: a) Intensitet i ulët i kujdesit: 1/3 ndërhyrje në javë, me një kohëzgjatje mesatare për çdo hyrje prej jo më shumë se 1 orë (nga 1–3 orë në javë); b) Intensitet mesatar i kujdesit: 3/6 herë në javë, me një kohëzgjatje mesatare për çdo hyrje prej së paku një orë (3–9 orë në javë); c) Intensitet i lartë i kujdesit: 5/7 herë në javë, me një kohëzgjatje mesatare për çdo hyrje për së paku një orë (nga 7 deri në 21 orë në javë). 4.3. Ka një dosje ku mbahen raportet javore të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe terapeutik.
		5. Plani i kujdesit shëndetësor ka procedura të shkruara, si për fillimin e shërbimit, ashtu edhe për transferimin apo ndërprerjen e shërbimeve.	5.1. Procedurat e fillimit të shërbimit janë shpjeguar qartë dhe ato janë në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara. 5.2. Para fillimit të ofrimit të shërbimit, punonjësi i shërbimit shëndetësor, pranë strukturave vendore viziton mjedisin e shtëpisë dhe bën një vlerësim paraprak për të vendosur nëse ka mundësi të ofrojë shërbimet e kërkuara. 5.3. Ka një kontratë të lidhur midis të dyja palëve para fillimit të shërbimit. Si minimum, kontrata përcakton misionin e përkujdesjes, vlerësimin e aftësive dhe nevojave individuale të përfituesve për shërbimet shëndetësore të ofruara, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve dhe të ofruesit të shërbimit shëndetësor.

			5.4. Procedurat për transferimin dhe ndërprerjen e shërbimeve janë shpjeguar qartë dhe është e justifikuar me kërkesën e vetë të moshuarit apo në rastet kur ky i fundit ka nevojë për një shërbim më të specializuar në spital.
Standardi 5 ***Respektimi i intimitetit dhe i dinjitetit të klientit gjatë shërbimeve personale higjienike*** **Person me aftësi të kufizuara ka intimitetin e nevojshëm gjatë kryerjes së nevojave personale dhe tualetit. Në rastet kur kanë nevojë për ndihmë, bëhet kujdes që gjatë ofrimit të përkujdesjes për higjienën, përfshirë ndihmën për t'u ndërruar e veshur, bërjen e banjës, pastrimin ditor, përdorimin e tualetit, përmbushjen e nevojave në shtrat, personi me aftësi të kufizuara ka intimitet dhe ai trajtohet me respekt e dinjitet.**	Mirëqenia e personit me aftësi të kufizuara nxitet dhe mbrohet nga abuzimet, gjatë kohës së ofrimit të asistencës në shtëpi. PAK-së u sigurohet intimitet dhe dinjiteti i nevojshëm për higjienën personale dhe procesin e tualetit. Kur ata kanë nevojë për ndihmë, shërbimi u jepet me ngrohtësi dhe respekt.	1. Gjatë kryerjes së shërbimeve të higjienës në familje bëhet kujdes të ruhet intimiteti i përfituesit. 2. Personeli ka/merr kualifikimin e duhur për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitet të klientit. 3. Klientët që kanë nevojë për ndihmë nxiten të jenë sa më të pavarur gjatë kryerjes së shërbimeve të kujdesit higjienik.	1.1. Intervista me klientët tregojnë se atyre u sigurohet intimiteti dhe dinjiteti i duhur. 1.2. Intervista me klientët tregon se klientët nuk kanë ankesa në këtë drejtim. 2.1. Ka dëshmi të kualifikimeve përkatëse të personelit në dosjen e tyre personale. 3.1. Plani individual i klientit e reflekton këtë kriter. 3.2. Intervista me klientët tregon se ata nuk kanë ankesa në këtë drejtim.
		3. Personat me aftësi të kufizuara nuk neglizhohen në kujdesin higjienik dhe veshmbathje.	3.1. Higjiena personale e personave me aftësi të kufizuara është e mirë. Ata janë të larë, të krehur dhe nuk mbajnë erë të rëndë. Është treguar kujdes për higjienën e gojës. 3.2. Personat me aftësi të kufizuara janë të veshur në mënyrë të përshtatshme për motin, me rroba personale që reflektojnë shijet dhe kërkesat e tyre individuale dhe tendencat e kohës.

Standardi 6 ***Mbrojtja e të drejtave, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimimit*** **Personat me aftësi të kufizuara apo personat përgjegjës për ta gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre ligjore, për t'u mbrojtur nga abuzimi financiar, psikologjik, fizik dhe seksual dhe dinë, dhe janë të aftë për t'u ankuar, nëse nuk janë të kënaqur me ndonjë aspekt të shërbimit në shtëpi. Çdo ankesë trajtohet në mënyrë serioze, pa vonesë, shoqërohet me veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe mbahen në dijeni për progresin, lidhur me trajtimin e saj, brenda një afati jo më shumë se 10 ditë.**	Personat me aftësi të kufizuara trajtohen me barazi, dinjitet, e pa diskriminim. Ata mbrohen nga abuzimi: fizik, financiar, material, psikologjik, seksual, neglizhenca, diskriminimi dhe dëmtimi i vetvetes. Ekziston një procedurë ankesash e thjeshtë, e qartë dhe transparente, e cila zbatohet në praktikë.	1. Punonjësit socialë që punojnë me personat me aftësi të kufizuara tregojnë respekt për dinjitetin e tyre në mënyrën se si sillen me ta dhe si i trajtojnë në të gjitha bashkëveprimet.	1.1. Vëzhgimet tregojnë që çdo person me aftësi të kufizuara trajtohet me respekt gjatë punës, në bashkëbisedim apo kur i jepet ndihmë. 1.2. Punonjësi social trajton me konfidencialitet, informacionin që ka për personat me aftësi të kufizuara. 1.3 Punonjësi social, që administron të ardhurat personale të personit me aftësi të kufizuara apo e ndihmon atë, mban shënime për të gjitha shpenzimet e bëra dhe sa herë që është e mundur edhe faturat përkatëse. Këto shpenzime futen në dosjen personale të personit me aftësi të kufizuara.
		2. Nuk ka trajtime të diferencuara që nuk lidhen me nevojat.	2.1. Të gjithë përfituesit e shërbimeve trajtohen njëlloj, pa shfaqje të favorizimit. 2.2. Kriteret e së drejtës për të përfituar shërbime të veçanta janë të formuluara qartë. Të gjithë personat e interesuar për shërbimin marrin informacion për kriteret e përfitimit të shërbimeve.
		3. Personat me aftësi të kufizuara mbrohen nga keqtrajtimi dhe abuzimi fizik, emocional dhe financiar.	3.1. Ka një proces të raportimit dhe verifikimit të neglizhencës, abuzimit apo keqtrajtimit në të cilin i kushtohet kujdes, si personit që raporton abuzimin, ashtu edhe personit që akuzohet për të. 3.2. Punonjësi social merr trajnim për identifikimin dhe raportimin e rasteve të abuzimit. 3.3. Dokumentacioni që shpjegon abuzimin, procesin e raportimit dhe verifikimit të tij. 3.3. Kur abuzimi raportohet nga personat me aftësi të kufizuara, ai mbështetet gjatë gjithë procesit të verifikimit nga një anëtar i

			personelit apo një person i jashtëm. 3.5. Personat me aftësi të kufizuara apo personat përgjegjës për ta ndihmohen të kuptojnë se ç'është abuzimi dhe si të mbrohen prej tij. 3.6. Masat që parashikohen të merren për mbrojtjen e personave nga abuzimi u shpjegohen atyre gjatë procesit të marrjes së miratimit të informuar. 3.7. Intervistat me përfituesit e shërbimeve ose përfaqësuesit e tyre tregojnë se ata dinë se ç'është keqtrajtimi dhe abuzimi dhe e njohin procesin e raportimit të tij.
		3. Ka një procedurë ankimimi të thjeshtë e të qartë, që është e hapur për të gjithë përfituesit dhe familjarët e tyre. Procedura përmban afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën.	3.1. Ka një dokument që sqaron procesin e ankimimit me një gjuhë të thjeshtë, sipas nevojës, në format të përshtatur. 3.2. Rregullorja e brendshme ka një pjesë për procedurën e ankimimit që përmban kushtet e konfidencialitetit, afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën. Të gjitha ankesat e marra me gojë apo shkrim dhe përgjigjet e dhëna mbahen në një dosje të veçantë. 3.3. Inspektimi i ankesave të regjistruara tregon se ato janë trajtuar me seriozitet dhe brenda afatit të duhur. 3.3. Përfituesit kanë marrë shpjegime se si të përdorin procedurat e ankimimeve dhe janë të qartë për të. 3.5. Personeli trajnohet për bashkëveprimin me personin që ka ankesa.

Standardi 7 ***Aktivitete integruese dhe plotësuese të kujdesit në shtëpi*** **Shërbimi i përgatitjes dhe/ose i ofrimit të ushqimit në shtëpi, nëse është e nevojshme, duhet konsideruar integrues dhe plotësues i shërbimeve të tjera që personi me aftësi të kufizuara i përfiton në shtëpi.**	Personave me aftësi të kufizuara u sigurohet shërbimi i ushqimit, nëse është e nevojshme, si dhe/ose ndihmesa në përgatitjen e ushqimeve dhe lëngje të shëndetshme, të sigurta, të shumëllojshme e në sasi të mjaftueshme për moshën, si dhe që plotësojnë dëshirat e tyre.	1. Me mbështetjen e ofruesit të shërbimit, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për të përgatitur ushqime dhe lëngje për veten e tyre. 2. Në rast të ofrimit të ushqimit dorëzimi i vakteve ushqimore duhet të garantohet 7 ditë në javë në një dërgesë të vetme ditore.	1. Personat me aftësi të kufizuara/ përfaqësuesi i tyre ligjor përgatisin vetë ushqimin e tyre në fundjavë, si edhe vaktet e mëngjesit, darkës ose zemrës, sipas udhëzimeve të mjekut. 2. Shërbimi i ofrimit të ushqimit mund të sigurohet nga një strukturë institucionale e pranishme në territorin ku ofrohet shërbimi, ose nëpërmjet marrëveshjeve me subjekte të treta, që duhet të garantojnë cilësinë e ushqimit dhe dërgesat pranë banesave të përfituesve.
		3. Personat me aftësi të kufizuara marrin një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të ekuilibruar sipas nevojave të tyre të rritjes dhe zhvillimit dhe nevojave kulturore, fetare.	3.1. Ekziston një menu javore që u përshtatet personave me aftësi të kufizuara, nevojave të tyre për lëndë ushqyese dhe kalori. Menuja hartohet nga mjeku, dietologu dhe iu bëhet e ditur paraprakisht përfituesve të shërbimit, të afërmve apo përfaqësuesit ligjor.
			3.2. Nga kontaktet e herëpashershme me përdoruesit e shërbimeve konfirmohet se ofrohet një menu javore për të cilën është diskutuar me ta. 3.3. Regjistrat ku janë shënuar porositë konfirmojnë se janë blerë rregullisht fruta dhe perime të freskëta. Janë të disponueshme fruta dhe perime të freskëta. 3.3. Janë plotësuar kushtet lidhur me shëndetin, higjienën, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimeve. 3.5. Ka evidenca që tregojnë se në raste të veçanta, siç janë ditëlindjet përgatitet diçka e veçantë.
Standardi 8 ***Jeta sociale në shtëpi dhe lidhjet me komunitetin*** **Personave me aftësi të kufizuara u ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në aktivitete**	Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi ta kalojnë ditën në përputhje me interesat dhe kërkesat e tyre shoqërore dhe shpirtërore,	1. Personat me aftësi të kufizuara kanë një program aktivitetesh që mbështet planin individual të tyre të shërbimeve, i hartuar në përputhje me interesat e tyre, me qëllim përfshirjen në komunitet.	1. Aktivitetet, që janë të planifikuara, përfshijnë, si aktivitete në grup dhe alternativa për aktivitete individuale për personat që nuk janë të interesuar të marrin pjesë në aktivitet në grup. 2. Plani i aktiviteteve hartohet së paku një

individuale e në grup, që synojnë zbavitjen, rritjen e njohurive, aktivizimin mendor dhe fizik në përputhje me mundësitë dhe dëshirat e tyre. Pjesëmarrja në aktivitet nuk është e detyrueshme. Rutina e jetesës dhe e aktiviteteve të përditshme ndryshon për t'u përshtatur dëshirave, kërkesave dhe mundësive të personave me aftësi të kufizuara.			herë në muaj dhe ai mbulon si aktivitete të zhvilluara në banesën e personave me aftësi të kufizuara, ashtu edhe aktivitete të zhvilluara në komunitet. 3. Kujdes të veçantë i kushtohet planifikimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse së bashku me bashkëmoshatarët. 3. Plani i aktiviteteve diskutohet, dokumentohet dhe u bëhet i njohur përfituesit, kujdestarëve dhe/ose familjarëve të tij. 5. Plani i aktiviteteve rishikohet çdo 6 muaj diskutohet, dokumentohet dhe u bëhet i njohur përfituesit, kujdestarëve dhe/ose familjarëve të tij.

Standardi 9 ***Shërbimet e asistencës shtëpiake, sociale dhe shëndetësore në ambientin natyral familjar ofrohen nga një staf i kualifikuar*** **Shërbimet e përkujdesjes shoqërore në shtëpinë e personave me aftësi të kufizuara realizohen nga punonjës socialë të kualifikuar dhe të trajnuar për të kryer këto shërbime, të cilët mund të veprojnë si asistentë të kujdesit personal, shoqërues, dhënës të ndihmës së parë shëndetësore, si terapistë, interpretë të gjuhës së shenjave. Marrëdhëniet e punësimit rregullohen me kontrata pune ose marrëveshje shërbimi. Personi me aftësi të kufizuara, kujdestari i tij, dhe/ose përfaqësuesi i tij (familjar apo një person i autorizuar prej tij) merr pjesë në vendimmarrjen për zgjedhjen e personit që i ofron këto shërbime dhe bën vlerësimin e punës së tij. Në përputhje me nevojat, shërbimet për një person apo familje mund të ofrohen nga punonjës i vetëm apo nga një ekip punonjësish, ku rolin e koordinatorit e ka punonjësi social, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar. Shërbimet që mund të plotësohen nga subjekte të licencuara, janë me cilësi dhe respektojnë të drejtat e njeriut.**	Shërbimet e përkujdesjes shoqërore në banesën e personave me aftësi të kufizuara plotësojnë nevoja të ndryshme funksionale të jetës, fizike, njohëse, psikologjike, komunikative, sociale, aftësuese/riaftësuese dhe terapeutike në përputhje me nevojat e tij. Shërbimet mbështetëse parandalojnë institucionalizimin dhe sigurojnë integrimin social pas largimit nga institucioni.	1. Çdo sektor i posaçëm i shërbimeve në nivele vendore ka së paku një punonjës me diplomë universitare si specialist i fushës që ndjek çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ofron shërbime të përkujdesjes komunitare për aftësinë e kufizuar, dhe kanë kualifikimin ose trajnimin e duhur për të ofruar këtë shërbim. 2. Shërbimi në banesë rregullohet nga kontrata pune ose marrëveshje shërbimi.	1.1. Punonjësi i caktuar për aftësinë e kufizuar ka një diplomë universitare në një nga këto fusha: punë sociale, pedagogji speciale, psikologji ose sociologji. 1.2 Personat që punojnë si infermierë kanë diploma universitare të infermierisë. 1.3. Personat që punojnë si fizioterapistë kanë diploma universitare në përputhje me natyrën e terapisë së ofruar. 1.4. Personat që punojnë si asistentë të kujdesit personal ose shoqërues kanë certifikatë të trajnimit të kërkuar për të kryer shërbimin. 1.5. Trajnimi i fundit është bërë jo më shumë se një vit përpara. Si minimum, trajnimi përmban njohuri për aftësinë e kufizuar, të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara dhe shmangien e neglizhimit, abuzimit e keqtrajtimit. Interpretët e gjuhës së shenjave kanë certifikatën e duhur për të kryer funksionin e tyre. 2.1. Në rastet e shërbimeve terapeutike shoqëruesi ose interpreti i gjuhës së shenjave, të ofruar nga një subjekt i licencuar, ka një kontratë pune me subjektin e licencuar që nënshkruhet nga personi me aftësi të kufizuara apo përfaqësuesi i tij ligjor. 2.2. Për personat me aftësi të kufizuara që ruajnë përfaqësimin e tyre ligjor, në rastet e shërbimeve të asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit ose interpretit të gjuhës së shenjave, të kryera nga një person brenda familjes ose një person jashtë familjes, por jo nga subjekte të licencuara, ka një marrëveshje shërbimi ndërmjet personit me aftësi të kufizuara dhe asistentit të kujdesit personal,

			shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shenjave. Marrëveshja e shërbimit përfshin dispozita mbi ndërprerjen e marrëdhënies në përputhje me legjislacionin shqiptar të punësimit. 2.3. Kur shërbimi i asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shenjave për personin me aftësi të kufizuara, që ka si përfaqësues ligjor një anëtar të familjes, kryhet nga një anëtar i familjes, ka një marrëveshje shërbimi midis personit që ofron shërbimin dhe sektorit të posaçëm të shërbimeve në nivele vendore. Marrëveshja e shërbimit përfshin dispozita mbi ndalimin e pagesës dhe kalimin e funksionit të asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shenjave te një familjar apo person tjetër. 2.4 Natyra e shërbimit të përshkruar në kontratë është në përputhje me vlerësimin e nevojave të personit me aftësi të kufizuara dhe pikësynimet e tij për zhvillim e aftësim dhe/ose gjithëpërfshirje në komunitet.
		3. Personi me aftësi të kufizuara, kujdestari i tij, apo familjari njoftohet dhe merr pjesë në zgjedhjen dhe vlerësimin e punës së personit që ofron shërbimet.	3.1. Personi me aftësi të kufizuara ruan të drejtën e zgjedhjes së personit që kryen shërbimin e asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit ose interpretit të gjuhës së shenjave, si edhe ndërprerjen e punës së këtij të fundit. Ndërprerja e punës kryhet në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi. Për shërbimet që nuk ofrohen nga subjekte të licencuara, procesi i ankimimit kalon në sektorin e posaçëm të shërbimeve në nivele vendore. 3.2. Një herë në vit bëhet vlerësimi i cilësisë

			së shërbimit të kryer nga personi që ka nënshkruar kontratën ose marrëveshjen e bashkëpunimit. 3.3. Për shërbimin e asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shenjave që nuk ofrohet nga një subjekt i licencuar, formulari i vlerësimit mbahet në dosjen e personit me aftësi të kufizuara në sektorin e posaçëm të shërbimeve në nivele vendore.
		4. Sa herë që është e nevojshme, më shumë se një person mund të punojë me një përfitues. Në këto raste, të gjithë punonjësit bashkëveprojnë për realizimin e planit individual. 5. Shërbimi i kryer është cilësor, në përputhje me planin individual të përfituesit.	4.1. Personi me aftësi të kufizuara ose familjari që është përfaqësues ligjor janë të kënaqur me bashkëveprimin. 4.2. Ka një dosje të vetme për përfituesin. Në dosje ka shënime të takimeve të bëra së paku çdo katër muaj ndërmjet të gjithë personave që punojnë me personin me aftësi të kufizuara dhe këtij të fundit dhe përfaqësuesit të tij ligjor. 5.1. Vlerësimi i kryer nga personi me aftësi të kufizuara, kujdestari i tij apo familjarët e tij për infermierin apo punonjësin social, tregon se shërbimi plotëson kërkesat cilësore të përfituesit, të planit të tij individual dhe ato të kontratës së punës apo marrëveshjes së shërbimit. 5.2. Për shërbimin e kryer nga subjektet e licencuara, ka një sistem mbikëqyrjeje dhe vlerësimi pune që është pjesë e rregullores së tyre. Vlerësimi i punës të punonjësit merr parasysh vlerësimin e bërë për të. 5.3 Kur punonjësi social i sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/ komunë vëren neglizhim, keqtrajtim apo abuzim të individit me aftësi të kufizuara nga asistenti i kujdesit personal apo shoqëruesi, rasti referohet për inspektim jashtë radhe.

Standardi 10 ***Shërbimet e asistencës shtëpiake sociale dhe shëndetësore në ambientin natyral familjar ofrohen nga një subjekt i licencuar*** **Subjekti i licencuar që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara ka procedura të qarta dhe të rregullta në punën e tij për të gjitha shërbimet e ofruara dhe monitorimin e tyre. Këto procedura janë të dokumentuara dhe të njohura, si nga personeli, ashtu edhe përfituesit e shërbimeve.**	Personat me aftësi të kufizuara marrin shërbime profesionale me cilësi të mirë dhe që ndjekin procedura të rregullta referimi, vlerësimi, planifikimi dhe të dhënies së shërbimeve. Procedurat respektojnë parimin e vendimmarrjes së mbështetur të përfituesit apo përfaqësuesit të tij ligjor.	1. Subjekti i licencuar ka procedura të qarta dhe të dokumentuar për referimin, vlerësimin e aftësive të PAK-së dhe nevojës për mbështetje, kriteret e përfitimit të shërbimeve, planifikimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre, monitorimin e shërbimeve dhe vlerësimin e efektivititetit të tyre.	1.1. Deklarata e qëllimit dhe rregullorja brendshme përmban kërkesa të cilat përshkruhen me një gjuhë të thjeshtë e sipas nevojës në format të përshtatur për procesin e referimit, vlerësimin e aftësive dhe nevojave për mbështetje të përfituesit, kriteret e përfitimit të shërbimit, planifikimin, ofrimin e monitorimin e shërbimeve, si edhe vlerësimin e efektivitetit të tyre me tregues të matshëm. 1.2. Procedurat nuk prekin dhe kufizojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. 1.3. Procedurat përfshijnë bashkëpunimin me organizata të tjera, për të realizuar dhënien e shërbimeve të nevojshme për përfituesin. 1.4. Subjekti i licencuar ka ndërtuar një sistem për monitorimin e ndjekjes së procedurave. 1.5. Subjekti i licencuar organizon anketime periodike së paku një herë në vit me personat që marrin shërbime ose përfaqësuesit e tyre ligjorë. Këto anketime tregojnë kënaqësi me cilësinë e shërbimeve. 1.6. Intervistat me personat me aftësi të kufizuara dhe/familjarët e tyre ose përfaqësuesit e tyre ligjorë tregojnë që ata janë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve.
		2. Subjekti i licencuar siguron, që si personeli ashtu edhe përfituesit e shërbimeve apo përfaqësuesit e tyre ligjorë t'i njohin procedurat.	2.1. Personeli është në gjendje të shpjegojë procedurat me fjalët e tyre. 2.2. Përfituesi apo përfaqësuesi ligjor kanë kopje të procedurave të shërbimeve, që marrin në një gjuhë të kuptueshme për ta.

		3. Të gjitha procedurat parashikojnë që përfituesi i shërbimeve apo përfaqësuesi i tij ligjor kanë të drejtën e vetëvendosjes dhe vendimmarrjes me mbështetje.	3.1. Procedurat përshkruajnë se në çfarë mënyre do të kërkohet dhe do të përfshihet mendimi i përfituesit apo përfaqësuesit të tij në procesin e referimit, vlerësimin e aftësive dhe nevojave për mbështetje të përfituesit, planifikimin, ofrimin e monitorimin e shërbimeve, si edhe vlerësimin e efektivitetit të tyre. 3.2. Personeli i intervistuar mund të përshkruajë me fjalët e tij procedurën e përfshirjes së përfituesit, duke dhënë shembuj konkretë nga puna në subjektin e licencuar. 3.3. Përfituesi i intervistuar apo përfaqësuesi i tij ligjor mund të përshkruajnë me fjalët e tyre procedurën e përfshirjes së përfituesit, duke dhënë shembuj konkretë nga përvoja e tyre me subjektin e licencuar.
		4. Subjekti i licencuar ka procedura të qarta për mbajtjen e dosjeve personale të personave që marrin shërbime bazuar në legjislacionin përkatës.	4.1. Çdo përfitues shërbimesh ka një dosje personale 4.2. Dosjet personale përmbajnë si minimum formularin e informacionit dhe një fotografi, raportin e vlerësimit, planin individual, raportet e ecurisë, autorizimin e nënshkruar nga personi apo përfaqësuesi ligjor për personat që mund të shohin dosjen apo japin informacion dhe shënimet mbi shërbimet e marra. 4.3. Dosjet personale mbahen në një vend të siguruar dhe përmbajtja e tyre është konfidenciale e mund të shihet vetëm nga personat e autorizuar.

		5. Subjekti i licencuar ka procedura të qarta, që përcaktojnë trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjekësorë.	5.1. Procedurat përshkruajnë rastet që do të përcaktohen si incidente, aksidente dhe emergjenca mjekësore. 5.2. Procedurat përshkruajnë masat që do të merren në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave mjekësore. 5.3. Procedurat përshkruajnë njoftimin e familjeve të personave, në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave. 5.4. Ka një dosje ku mbahen raportet e rasteve të incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjekësore. 5.5. Në vendin ku ofrohet shërbimi ka një dokument me numrat e telefonit të kontaktit për raste emergjence për çdo pjesëmarrës në program.
		6. Subjekti i licencuar ka procedura të qarta për mbajtjen dhe dhënien e barnave që mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga abuzimi dhe keqpërdorimi.	6.1. Procedurat përcaktojnë që vetëm me rekomandimin e mjekut jepen barnat. 6.2. Procedurat përcaktojnë që barnat mbahen të mbyllura me çelës që zotërohet vetëm nga personeli i caktuar për shpërndarjen e tyre. 6.3. Personeli i caktuar për shpërndarjen e barnave ka marrë një trajnim mbi procedurat e mbajtjes së barnave edhe shpërndarjes së tyre që mbulon edhe masat që duhen marrë në raste problematike. Ekziston dokumenti që vërteton trajnimin. 6.4. Subjekti i licencuar mban shënime të rregullta për shpërndarjen e barnave, që si minimum përmbajnë: emrin, orën, barnat, dozën, mënyrën e marrjes dhe emrin e personit që bën shpërndarjen dhe reaksionet e vëna re.

		7. Subjektet e licencuara që ofrojnë shërbime transporti kanë procedura të qarta për to.	7.1. Procedurat përcaktojnë se mjeti që përdoret për transport është i përshtatshëm dhe drejtohet nga një person i pajisur me patentë të vlefshme. 7.2. Procedurat përcaktojnë se çdo person që transportohet, udhëton në një sedilje të veçantë me rripin e sigurimit, me përjashtim të personave, të cilët transportohen në karrocat me rrota, për të cilët bëhen rregullime të veçanta. 7.3. Procedurat përcaktojnë që të gjithë personat në mjet janë nën mbikëqyrjen e shoferit apo të një ndihmësi gjatë gjithë kohës së transportit. 7.4. Personat që bëjnë transportin janë të pajisur me një telefon celular dhe kanë informacionin e duhur për rastet e emergjencave.
		8. Subjektet e licencuara kanë një program aktivitetesh që mbështet planin individual të përfituesve dhe interesat e tyre, si edhe përfshirjen në komunitet.	8.1. Aktivitetet, që janë të planifikuara, përfshijnë si aktivitete në grup, ashtu dhe alternativa për aktivitete individuale për personat që nuk janë të interesuar të marrin pjesë në aktivitet në grup. 8.2. Aktivitetet janë në përputhje me misionin e subjektit të licencuar dhe mbulojnë fusha të ndryshme. 8.3. Plani i aktiviteteve hartohet së paku një herë në muaj dhe ai mbulon si aktivitete të zhvilluara në banesën e personit me aftësi të kufizuara, ashtu edhe aktivitete të zhvilluara në komunitet. 8.4. Kujdes të veçantë i kushtohet planifikimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse së bashku me bashkëmoshatarët.

			8.5. Plani i aktiviteteve dokumentohet dhe u bëhet i njohur përfituesit dhe familjarëve të tij. 8.6. Subjekti i licencuar ruan kopjet e planeve të aktiviteteve për 12 muajt e fundit.
		9. Subjekti i licencuar ka procedura të shkruara, si për pranimin, ashtu edhe për transferimin apo ndërprerjen e shërbimeve.	9.1. Procedurat e pranimit janë shpjeguar qartë dhe ato janë në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara. 9.2. Para pranimit, subjekti i licencuar viziton mjedisin e shtëpisë dhe bëjnë një intervistë paraprake. 9.3. Para pranimit, subjekti i licencuar bën një vlerësim paraprak, për të vendosur nëse ka mundësi të ofrojë shërbimet e kërkuara. 9.3. Para fillimit të shërbimit lidhet kontrata midis të dyja palëve. Si minimum, kontrata përcakton misionin dhe filozofinë e përkujdesjes, vlerësimin e aftësive dhe nevojave individuale të përfituesve për shërbimet e ofruara, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve dhe të personelit. 9.5. Subjekti i licencuar ka një listë të personave që kanë kërkuar të marrin shërbime dhe datën e kërkesës. Dokumentacioni i subjektit të licencuar tregon, se periudha ndërmjet datës kur bëhet kërkesa për shërbim dhe datës së ofrimit të tij është e arsyeshme. 9.6. Procedurat për transferimin dhe ndërprerjen e shërbimeve janë shpjeguar qartë. 9.7. Transferimi apo ndërprerja e shërbimit është e justifikuar me kërkesën e personit ose pamundësitë e subjektit të licencuar të ofrojë shërbimet e duhura.

Standardi 11 *Kërkesat organizative dhe funksionale të subjektit të licencuar* **Subjekti është licencuar për të kryer të gjitha shërbimet që ofrohen. Ai ka një numër të mjaftueshëm personeli me figurë morale të pastër, kualifikimet e duhura dhe një strukturë organizative e procedura administrative e financiare, që mbështesin funksionimin e tij. Subjekti ka kritere për pjesëmarrjen e vullnetarëve.**	Person me aftësi të kufizuara i merr shërbime nga një subjekt i licencuar, me një strukturë organizative dhe funksionale që mbështet punën cilësore të punonjësve me kualifikimet e duhura në përputhje me shërbimet e ofruara.	1. Subjekti është licencuar për të kryer të gjitha shërbimet që ofrohen.	1.1. Licenca është e vlefshme. 1.2. Të gjitha shërbimet e ofruara janë të licencuara.
		2. Subjekti i licencuar ka personel të mjaftueshëm e të kualifikuar.	2.1. Numri i punonjësve është i mjaftueshëm për të ofruar shërbimet dhe mbuluar nevojat e personave dhe kualifikimet e përcaktuara në standardin 9. 2.2. Për çdo pozicion në subjektin e licencuar ka përshkrime pune, ku përshkruhen përgjegjësitë, arsimi dhe trajnimet e kërkuara. 2.3. Marrja e një punonjësi të ri në punë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Punës. 2.4. Të gjithë punonjësit kanë dëshmi penaliteti që vërteton figurën morale të tyre. 2.5. Subjekti i licencuar ka dhe realizon një plan trajnimi të detyrueshëm, të përvitshëm për të gjithë punonjësit. Si minimum, ky trajnim jep njohuri për çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar, të drejtat e PAK-së, parandalimin e neglizhencës, abuzimit dhe keqtrajtimit, si dhe për detyra funksionale të punonjësve. 2.6. Puna e personelit vlerësohet një herë në vit; formulari i vlerësimit firmoset nga punonjësi social që kryen vlerësimin.

		3. Subjekti i licencuar ka procedura për punësimin e vullnetarëve dhe mbikëqyrjen e tyre.	3.1. Çdo vullnetar plotëson një aplikim për të punuar më subjektin e licencuar. Bashkë me aplikimin dorëzohet dëshmia e penalitetit. 3.2. Kërkesa shqyrtohet dhe aprovohet nga një punonjës i subjektit të licencuar. 3.3. Vullnetarët punojnë të mbikëqyrur dhe në prezencë të një punonjësi të subjektit të licencuar.
Standardi 12 ***Standarde të personelit për kujdesin në shtëpi të personave me aftësi të kufizuara*** **Çdo njësi e pushtetit vendor cakton një punonjës social të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale/sektori i posaçëm të ndjekë çështjet e aftësisë së kufizuar.**	Shërbimi i kujdesit shoqëror dhe shëndetësor në shtëpi duhet të ketë standarde dhe procedura homogjene në gjithë territorin kombëtar.	Çdo njësi vlerësimi e nevojave/sektor i posaçëm në njësitë administrative ka së paku një punonjës social për frymë banorësh, si specialist i fushës që ndjek çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ofron shërbime të asistencës shtëpiake për PAK-në (një punonjës social çdo 30.000 banorë për zonat fushore dhe çdo 20/25.000 banorë për zonat malore).	1. Ekziston një përshkrim i punës së punonjësit që mbulon këto çështje e aftësisë së kufizuar: 2. Identifikimin në mjedisin ku jetojnë e nevojave të PAK-së dhe evidentimin e tyre në dosjen e hapur për këtë qëllim. 3. Raportimin në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale për problematikën e aftësisë së kufizuar dy herë në vit. 4. Bashkëpunimin me organizatat, që mbrojnë interesat e aftësisë së kufizuar. 5. Sipas nevojës, sigurimin e përshtatjes së mjedisit, materialeve të përshtatura dhe interpretit të gjuhës së shenjave për takime të organizatave të personave me aftësi të kufizuara me nivelin vendor. 6. Ndihmën e asistentëve të kujdesit personal apo shoqëruesve, që marrin përfitim kujdestarie, me mbështetje emocionale, referime, avokati për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, trajnim etj. 7. Kualifikimi profesional mbulon njohuritë për të drejtat e njeriut për PAK-në, shprehitë e punës për asistencën shtëpiake dhe mbështetjen e asistentëve të kujdesit personal që marrin përfitim kujdestarie.

			8. Kualifikimi i fundit profesional është bërë jo më shumë se një vit përpara.
		2. Strukturat vendore mund të kontraktojnë operatorë për dhënien e kujdesit, për të ndihmuar në aktivitetet shtëpiake/familjare pranë banesës së përfituesit. Çdo operator duhet të garantojë marrjen në ngarkim të 3–5 të moshuarve me nevoja të ndryshme përkujdesjeje. Në rastet e paaftësisë së plotë të të moshuarit, personeli duhet të shtohet në kufirin e një operatori çdo 2/3 përfitues.	2.1. Në planin e punës të secilit operator, duhet të merren parasysh edhe kohët fizike, që nevojiten për transferimin nga një banesë në tjetrën, si dhe kohët për organizimin e punës në grup. 2.2. Duhet të parashikohen takime kolektive për programimin dhe vlerësimin e aktiviteteve midis operatorëve dhe punonjësit social që ka edhe funksionet e koordinatorit të shërbimit
		3. Në përbërje të stafit të Shërbimit të Kujdesit shoqëror dhe Shëndetësor në shtëpi për çështjet e aftësisë së kufizuar, mund të ketë prani dhe të një stafi të specializuar shëndetësor: I. Të mjekut; II. Të fizioterapistit; III. Të Infermierit.	3.1.1. Në rast të kujdesit të integruar me strukturat rajonale shëndetësore, prania e mjekut duhet të sigurohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë (mjeku i përgjithshëm përgjegjës për territorin). 3.1.2. Kjo prani duhet të sigurohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. 3.1.3. Duke pasur parasysh që prania e këtij operatori është më e shpeshtë se e operatorëve të tjerë shëndetësorë, është e nevojshme punësimi i tij në marrëveshje mes njësisë/njësive vendore përgjegjëse për shërbimin dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë. 3.2. Në procesin e vlerësimit të nevojave të

			planit individual të përkujdesjes dhe të zbatimit të këtij të fundit, duhet të parashikohen takime kolektive, për programimin dhe vlerësimin e aktiviteteve midis operatorëve. 3.3. Punonjësit socialë ka edhe funksionet e koordinatorit të shërbimit.
Standardi 13 **Njësia e qeverisjes vendore siguron partneritet me të gjitha grupet e interesit në fushën e aftësisë së kufizuar, mbi bazën e parimeve të gjithëpërfshirjes.**	Njësitë e qeverisjes vendore punojnë së bashku me personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre, asistentët e kujdesit personal apo shoqëruesit që marrin përtimin e kujdestarisë, interpretët e gjuhës së shenjave dhe organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe për parandalimin e shmangien e diskriminimit dhe përjashtimit shoqëror.	1. Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha partneritetet vendore ku trajtohen çështje që prekin aftësinë e kufizuar.	1.1. Numri i personave me aftësi të kufizuara mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara në mbledhjet dhe takimet e organizuara nga njësia vendore ku trajtohen çështje që prekin aftësinë e kufizuar. 1.2. Përshtatjet e arsyeshme të krijuara për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të personave që përdorin karroca (nëpërmjet zgjedhjes së mjedisit të përshtatshëm), e personave me probleme shikimi, e personave që nuk dëgjojnë dhe të personave me aftësi të kufizuara intelektuale. 1.3. Procesverbalet e mbledhjeve dhe takimeve të njësive vendore ku kanë marrë pjesë persona me aftësi të kufizuara.
		2. Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë pjesëmarrjen aktive konsultative të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe të vetë personave me aftësi të kufizuara në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.	2.1. Informacioni i shpërndarë tek organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara mbi planifikimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar. 2.2. Raporte të mbledhjeve që tregojnë pjesëmarrjen e organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me aftësi të kufizuara në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar. 2.3. Intervista me drejtues të organizatave që

			përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe persona me aftësi të kufizuara që tregojnë për pjesëmarrjen e organizatës së tyre në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.
		3. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara dhe subjekte të licencuara, ngrenë gradualisht, në përputhje me mundësitë e tyre, shërbime të ndryshme që mbulojnë të gjitha grup-moshat, kategoritë e aftësisë së kufizuar, si edhe nevojat e ndryshme funksionale në përputhje me moshën.	3.1. Harta e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara mbulon shërbime për fëmijë, të rritur e të moshuar të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar sipas nevojave të territorit. 3.2. Plani i komunitetit përfshin ngritjen graduale të shërbimeve të shumëllojshme për personat me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme.
		3. Njësitë e qeverisjes vendore mbështesin shërbimet e ofruara nga subjektet e licencuara, nëpërmjet fondit social dhe sigurojnë cilësinë e tyre.	3.1. Sipas mundësive, njësitë e qeverisjes vendore mbështesin financiarisht shërbimet e ofruara nëpërmjet procesit të konkurrimit. 3.2. Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga subjektet e licencuara në përputhje me legjislacionin ne fuqi.